

## **GJYKATA KOMUNALE E GJILANIT**

**GJYKATA KOMUNALE E GJILANIT** përmes trupit gjykues të përbërë nga Gjyqtarja Civile e EULEX-it ROSITZA BUZOVA si kryetare e trupit gjykues, Gjyqtarit vendor BERAT SPAHIUT dhe Gjyqtarit vendor HALIL ZAHIRI, si anëtar të trupit gjykues, në pajtim me nenin 5, paragrafi 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 27/2008),

Në lëndën civile të paditësit ENVER AHMETI nga GJILANI, kundër të paditurve DRAGOLJUB SIMONOVIC dhe JOVAN SIMONOVIC në bazë të padisë të dy nga GJILANI, aktualisht me vendbanim dhe adresë të panjohur, në lëndën- vërtetimi i pronësisë në pronën e paluajtshme me vlerën e kontestit në shumën prej 250 €,

Duke vepruar sipas kërkesës për rihapje të procedurave të shkallës së parë të përfunduar me aktgjykimin C.no.610/2002 të Gjykatës Komunale të GJILANIT, me datë 12 dhjetor 2002, e paraqitur në emër të të paditurve të përmendur më lart DRAGOLJUB SIMONOVIC dhe JOVAN SIMONOVIC me VLASTIMIR PETROVIC dhe ELMI QERIMI, të dy avokatë nga GJILANI,

*Pas këshillimit dhe votimit në seancën e trupit gjykues me 12 maj 2011,*

Pas vlerësimit të pranueshmërisë të këtij mjeti të jashtëzakonshëm në pajtim me nenin 425, paragrafi 1 i Ligjit të Procedurës Kontestimore ("Gazeta Zyrtare e RSFJ" Nr. 4/1977, 36/1980, 69/1982, 58/1984, 74/1987, 57/1989, 20/1990, 27/1990, 35/1991 dhe "Gazeta Zyrtare e RSJ" Nr. 27/1992, 31/1993, 24/1994, dhe 12/1998) (LPK 1977) në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-006 mbi Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 38/2008) (LPK 2008),

Përmes kësaj merr këtë:

### **A K T V E N D I M**

**I.** Kërkesa për rihapje të procedurave të shkallës së parë të përfunduar me aktgjykimin C.nr.610./2002 e Gjykatës Komunale të GJILANIT, me datë 12 dhjetor 2002, e paraqitur me 7 shkurt 2008 për të paditurit DRAGOLJUB SIMONOVIC dhe JOVAN SIMONOVIC me avokatët VLASTIMIR PETROVIC dhe ELMI QERIMI nga GJILANI, **HUDHET POSHTË.**

**II.** Kopjet e vërtetuara zyrtare të aktgjykimit C.nr. 610/2002 të Gjykatës Komunale të GJILANIT, të datës 12 dhjetor 2002 me përkthimin në gjuhën serbe duhet t'iu **DËRGOHEN** të paditurve për ankimim brenda periudhës prej 15 ditëve nga data e pranimit, para Gjykatës së Qarkut të GJILANIT në pajtim me nenin 348, paragrafi 1, fjalia e parë e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore ("Gazeta Zyrtare e RSFJ" Nr. 4/1977, 36/1980, 69/1982, 58/1984, 74/1987, 57/1989, 20/1990, 27/1990, 35/1991 dhe "Gazeta Zyrtare e RSJ" Nr. 27/1992, 31/1993, 24/1994, dhe 12/1998) në lidhje me

nenin 533, paragrafi 1 i Ligjit No. 03/L-006 mbi Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 38/2008).

## ARSYETIM

### I. Historiati procedural

1. Me 25 nëntor 2002, ENVER AHMETI nga GJILANI paraqiti një padi kundër DRAGOLJUB SIMONOVIC dhe JOVAN SIMONOVIC. Gjoja se në vitin 1978 paditësi bleu nga të paditurit ngastrën kadastrale nr.457/1, me kulturë – arë, e klasit të II, në vendin “GAVRAN”, me sipërfaqe prej 0.22.00 ha, të regjistruar në Listën Poseduese nr.406, ZK GJILAN. Pas pagesës së çmimit, pasuria e patundshme ishte dorëzuar nga shitësit tek blerësi, i cili që nga viti 1978 e ka shfrytëzuar atë pa qenë i penguar nga askush. Asnjë kontratë me shkrim nuk është nënshkruar për shkak të pengesave administrative. Më vonë transaksionet e këtij lloji në mes të palëve të nacionaliteteve të ndryshme ka qenë e ndaluar nga ligji diskriminues. Deklarimi i gjykatës ishte që të konfirmojë pronësinë e paditësit në këtë ngastër kadastrale bazuar në parashkrimin fitues dhe transaksionin ligjor të shitblerjes, të detyrojë të paditurit që të njohin të drejtën e tij, dhe regjistrimin e kësaj prone të paluajtshme nga Drejtorati për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi – GJILAN në emër të paditësit.
2. Padia është regjistruar për gjykim si C.nr.610/2002 në Gjykatën Komunale të GJILANIT.
3. Paditësi kurrë nuk ka qenë i obliguar nga gjykata siç kërkohet me nenin 281 në lidhje me nenin 109, paragrafët 1 dhe 2 të LPK-së 1977 të kompletojë këtë padi me vendbanimet e tanishme dhe/apo adresat e të paditurve si kërkesa të obligueshme për përmbajtjen e saj në pajtim me nenin 186, paragrafi 1 në lidhje me nenin 106, paragrafi 2 LPK 1977.
4. Asnjë ftesë apo lajmërim tjetër kurrë nuk është dërguar në lëndën C.nr.610/2002 nga GJK e GJILANIT tek të paditurit në mënyrë që të verifikohet zyrtarisht se ata nuk kanë mundur të gjinden në adresën e tyre permanente të fundit të regjistruar në GJILAN.
5. Asnjë veprim procedural nuk është ndërmarrur *ex officio* në C.nr.610/2002 nga GJK e GJILANIT për të gjetur informatat e kërkuara për adresën aktuale të DRAGOLJUB dhe JOVAN SIMONOVICIT nga institucionet administrative kompetente apo në ndonjë mënyrë tjetër siç kërkohet ligjërisht nga neni 148 LPK 1977.
6. Asnjë aktvendim nuk është lëshuar në C.nr.610/2002 nga GJK e GJILANIT për emërimin e përfaqësuesit të përkohshëm për ndonjërin nga dy të paditurit sipas nenit 84, paragrafi 2, pika 3 dhe neni 278 LPK 1977. Gjykata po ashtu nuk e ka lajmëruar as institucionin kompetent të kujdestarisë në mënyrë që të iniciojë emërimin e përfaqësuesit të tyre siç kërkohet me nenin 84, paragrafi 3 i LPK-së 1977.

7. Padia nuk iu është dërguar të paditurve për përgjigje siç kërkohet me nenin 277, paragrafi 2 dhe neni 284, paragrafi 2 LPK 1977.
8. Asnjë séance përgatitore nuk është caktuar, pa asnjë arsyetim sipas nenit 284, paragrafi 3 i LPK-së 1977 bazuar në kërkesë padinë dhe natyrën e kontestit.
9. Seanca kryesore ishte mbajtur në një seancë gjyqësore publike me 12 dhjetor 2002, 17 ditë pasi që C.nr.610/2002 e GJK të GJILANIT ishte regjistruar me 25 nëntor 2002. Asnjëra nga palët ndërgjyqëse nuk ishte ftuar.
10. Pavarësisht nga të gjitha parregullsitë procedurale më lart , dhe pa tërheqjen ekskluzive eksplicite të kundërshtimeve nga palët në mbajtjen e seancës kryesore me 12 dhjetor 2002, ajo nuk është shtyrë por është shpallur e hapur nga Kryetari i trupit gjykues pa kontrolluar nëse të paditurit kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt dhe nëse ka arsye të justifikueshme për mungesën e tyre sipas nenit 294 LPK 1977. Në bazë të procesverbalit , përpos paditësit i cili ka qenë personalisht, në séancë me 12 dhjetor 2002 ka marrur pjesë gjithashtu edhe Avokati MASAR MORINA si “përfaqësues i përkohshëm i të paditurve“. Sidoqoftë ,asnjë aktvendim nuk është regjistruar se është marrur në këtë séancë për emërimin e tij në këtë kapacitet procedural në çfarëdo baze.
11. Gjatë séancës dëgjimore me 12 dhjetor 2002, Lista Poseduese nr. 406, ZK GJILAN, bashkangjitur me padinë , ishte lexuar dhe dy dëshmitarë të propozuar nga paditësi ishin dëgjuar. Pa asnjë dëshmi tjetër të përmendur gjykimi ishte përfunduar.
12. Me aktgjykimin C.nr.610/2002 të GJK të GJILANIT me datë 12 dhjetor 2002, padia ishte aprovuar tërësisht –pronësia e paditësit ENVER AHMETI në ngastrën kadastrale nr.457/1, me kulturë-arë, klasa e dytë, në vendin “GAVRAN”, me sipërfaqe prej 0.22.00 ha, të regjistruar në Listën Poseduese nr.406, ZK GJILAN ishte konfirmuar bazuar në parashkrimin fitues, të paditurit DRAGOLJUB dhe JOVAN SIMONOVIC ishin obliguar që të njohin të drejtën e tij dhe Drejtorati për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi – GJILAN ishte urdhëruar që të bëjë ndryshimet përkatëse në librat kadastral.
13. Me 19 dhjetor 2002, aktgjykimi i datës 12 dhjetor 2002 ishte dërguar në kopje tek ENVER AHMETI, MASAR MORINA, avokat nga GJILANI dhe Drejtoratit për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi – GJILAN.
14. Me 7 shkurt 2008, një kërkesë për rihapje të procedurave të shkallës së parë të përfunduar me aktgjykimin C.nr.610/02 të GJK -GJILAN, të datës 12 dhjetor 2002 ishte paraqitur në emër të paditurve DRAGOLJUB SIMONOVIC dhe JOVAN SIMONOVIC me VLASTIMIR PETROVIC dhe ELMIR QERIMI, të dy avokatë nga GJILANI. Baza ligjore e thirrur në mënyrë eksplicite në përmbajtjen e saj siç parashihet me nenin 424, paragrafi 2 LPK 1977 ishte sipas nenit 421, pika 2 e LPK-së 1977 se këtyre palëve ndërgjyqëse nuk iu është dhënë e drejta për të marrur pjesë në gjykim , për shkak të veprimeve të paligjshme të gjykatës si mos-dërgimi i padisë për përgjigje, mos thirrja për séancën kryesore, mungesa e kërkesës për informata e dërguar tek autoritetet kompetente administrative për adresat e tyre në pajtim me

nenin 148 LPK 1977. Kërkesa është që kjo gjykatë e shkallës së parë të lejojë rihapjen e procedurave të kompletuara me aktgjykimin C.nr.610/2002 të GJK GJILAN, të datës 12 dhjetor 2002 pas anulimit të tij dhe për vazhdimin e procedurës kontestimore në këtë lëndë civile pasi që aktvendimi përkatës të marr formën e prerë.

15. Asnjë veprim procedural nuk është ndërmarrur nga gjykata në këtë procedurë të mjetit të jashtëzakonshëm juridik pas inicimit të tij me 7 shkurt 2008, deri në caktimin e lëndës nën kompetencën e gjyqtarëve të EULEX-it.

## II. Kompetenca e Gjykatës Komunale të GJILANIT

16. C.nr.610/2002 e GJK të GJILANIT ishte përzgjedhur në pajtim me nenin 5, paragrafi 1, pika c) e Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat) me aktvendimin e gjyqtarëve të EULEX-it, të datës 16 dhjetor 2010. Seanca dëgjimore sipas nenit 5, paragrafi 7, fjalia e parë e ligjit të njëjtë ishte mbajtur me 22 shkurt 2011 nga gjykatësi i EULEX-it pas delegimit nga Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it me vendimin ref.nr.JC/EJU/OPEJ/2230/mgc/11, të datës 28 janar 2011. Me aktvendimin e këtij delegimi, të datës 24 shkurt 2011, në pajtim me nenin 5, paragrafi 7, fjalia e dytë Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, rasti është caktuar për shkak të procedurës së mjetit të jashtëzakonshëm juridik në pritje tek trupi gjykues prej tre gjyqtarëve të GJK të GJILANIT sipas nenit 5, paragrafi 2, fjalia e parë dhe e dytë dhe paragrafi 4 i Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat me kryetarin e trupit gjykues nga EULEX dhe dy gjykatës vendorë-si anëtarë të trupit. Këta të fundit ishin caktuar pas vendimit derogues ref.nr.JC/EJU/OPEJ/2298/mgc/11 të Kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it, të datës 3 mars 2011 sipas nenit 5, paragrafi 5 i Ligji Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat me vendimin AGJ.nr.17/11 të Kryetarit të GJK të GJILANIT të datës 21 mars 2011.

17. Të gjitha lëndët civile lidhur me pronat brenda kompetencave të gjyqtarëve të EULEX-it pa marrë parasysh tipin e procedurave të tyre në pritje duhet të gjykohen nga trupat gjykues të përbërë prej tre gjyqtarëve profesionistë me gjykatësin e EULEX-it si kryetar i trupit gjykues - neni 5, paragrafët 2 dhe 4 Ligji Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat. Përbërja e gjykatës në këto lëndë civile duhet të përcaktohet në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-053 mbi Kompetenca i cili si *lex specialis* mbizotëron nenin 41 – 42 të LPK-së 1977, si dhe nenin 15 LPK 2008. Kjo është arsyeja pse duke qenë i kompozuar ligjërisht në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat ky trup gjykues i përzier prej tre gjyqtarëve është i autorizuar me kompetencën për të vendosur këtë lëndë civile sipas procedurës në pritje të mjetit të jashtëzakonshëm juridik .

## III. Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës për ri-hapje

18. Me aktvendimin e atakuar C.nr.610/2002 të GJK të GJILANIT, i lëshuar me 12 dhjetor 2002 procedura e kësaj lënde ishte përfunduar në shkallën e parë para hyrjes në fuqi të LPK 2008 me 6 tetor 2008. Për këtë arsye sipas rregullit ekplicit

kalimtar të nenit 533, paragrafi 1 i LPK-së 2008 për hipoteza të tilla , dispozitat e vjetra të LPK-së 1977 do të jenë të aplikueshme për çfarëdo procedure të mëtutjeshme në lëndën e njëjtë. Prandaj, ky mjet juridik i jashtëzakonshëm, i iniciuar me 7 shkurt 2008 është nën regjimin normativ të neneve 421 – 428 LPK 1977.

**19.** Në mënyrë që të vendoset për kërkesën e rihapjes, gjykata përpara duhet të vlerësojë nëse të gjitha kërkesat ligjore të pranueshmërisë së saj janë përmbushur. Përkatësisht , faza e parë në këtë procedurë të mjetit të jashtëzakonshëm juridik është ekzaminimi preliminar sipas nenit 425, paragrafi 1 LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008 nëse kërkesa është e vonuar, jo e plotë dhe/apo e palejueshme.

**20.** Të gjitha mjetet juridike të rregulluara në 6 nenet e kapitullit XXVI të LPK 1977, duke përfshirë përsëritjen sipas nenit 5, janë të cilësuara në tituj dhe dispozita si të *jashtëzakonshme*, ndryshe nga mjetet juridike nën dy nenet e kapitullit XXV të LPK 1977 të cilat janë të *(zakonshme) të rregullta*. Dallimi kryesor ne mes tyre është bazuar në *përfundimin/jo-përfundimin e* vendimeve gjyqësore të ankimuara nga ato të kategorisë së parë dhe të dytë përkatësisht. Në pajtim me këtë ndryshim të përgjithshëm, përsëritja sipas Kapitullit XXVI, paragrafi 5 i LPK-së 1977 si mjet i jashtëzakonshëm juridik në mënyrë eksplicite është i kufizuar në kapacitetin e saj me nenin 421 vetëm për procedurat e kompletuara *me vendime gjyqësore të formës së prerë*. Kërkesa për vendime të formës së prerë është e aplikueshme për të gjitha *vendimet juridike* të ankimuar nga ky mjet i jashtëzakonshëm juridik pasi që procedurat mund të përfundohen me një aktgjykim apo aktvendim (neni 129, paragrafi 1 LPK 1977). Përsëritja është instrument ligjor kundër të gjitha këtyre vendimeve gjyqësore që kanë hyrë në fuqi, edhe pse janë marrur me shkelje të rënda procedurale të numëruara në nenin 421, pikat 1 - 9 LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008. Nuk është i ankimuar sikur të kishte qenë i iniciuar vetëm nëse gjykimi të ishte përfunduar nga një vendim gjyqësor ligjërisht i detyrueshëm. Për këtë arsye, nuk është faza e saj, por *një procedurë juridike e pavarur për kontrollimin e tyre të rastit* kur shkeljet e numëruara detalisht në nenin 421, pika 1 - 9 LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008 ekziston. Ai është i përcaktuar për të rihapur procedurat që anulojnë *vendimet gjyqësore të formës së prerë* që më parë janë lëshuar në mënyrë të paligjshme (neni 427, paragrafi 2 LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008), kështu që rigjykimi mundet të mbahet në çështjen kryesore dhe mundet të gjykohet si vendim i ri gjyqësor valid (neni 427, paragrafi 3 LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008).

**21.** Përsëritja sipas Kapitullit XXVI, neni 5 i LPK-së 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008 për këtë arsye është e pranueshme në mënyrë ekskluzive dhe vetëm për *veprimet juridike që kanë hyrë në fuqi* duke qenë: 1) në parim jo e ankimeshme me mjetin juridik të rregullt sipas kapitullit XXV të LPK 1977 apo Kapitullit XIII LPK 2008 (p.sh.aktgjykimi i shkallës së dytë); 2) jo-i ankimuar nga ankesat ne afatin ligjor apo me ankesë të tërhequr; *apo* 3) i ankimuar me ankesë, i hedhur poshtë apo i refuzuar nga gjykata e shkallës së dytë.

22. Kjo kërkesë për praninë sipas nenit 421, pikat 1 - 9 LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008 si i detyrueshëm për të gjitha bazat përsëritëse nuk është plotësuar në këtë lëndë civile pasi që *aktgjykimi C.nr.610/2002 i GJK GJILAN, i datës 12 dhjetor 2002 ende nuk është i formës së prerë*. Pasi që padia për konfirmimin e pronësisë të ENVER AHMETIT kundër DRAGOLJUB dhe JOVAN SIMONOVIC ishte vendosur bazuar në aprovimin e saj në mungesë të palës kundërshtare, në pajtim me nenin 333, paragrafi 1 LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008 aktgjykimi merr *formën e prerë kur nuk mundet të kundërshtohet më tutje me ankesë*. Me kusht që të gjitha palët në C.nr.610/2002 të GJK të GJILANIT në mënyrë individuale janë të ofruar me këtë të drejtë procedurale sipas nenit 348, paragrafi 1, fjalia e parë LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008, sipas dispozitës së njëjtë *forma e prerë* e këtij aktgjykimi mundet të ndodh vetëm kur : 1) kopjet e saj janë pranuar në mënyrë të rregullt nga *të gjitha palët ndërgjyqëse*; dhe 2) afati kohor prej 15 ditëve për ankimim ka skaduar *për secilin nga ata*. Pasi që këto kërkesa janë të detyrueshme në mënyrë të njëjtë për të gjitha palët, pa marrë parasysh statusin e tyre, mosplotësimi i tyre në lidhje me të paditurit në fjalë në mënyrë automatike *përfshihet këtë formë të prerë të* aktgjykimit C.nr.610/2002 të GJK të GJILANIT, të datës 12 dhjetor 2002 sipas nenit 333, paragrafi 1 LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008. Pasi që ende mundet të ankimohet nga këto palë ndërgjyqëse, ai nuk e ka fituar aktvendimin e formës së prerë dhe në pajtim me nenin 421 LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008 është i papranueshëm për përsëritje. Argumentet janë si vijon.

23. Periudha 15 ditore për ankimim kundër aktgjykimit të shkallës së parë siç konstatohet në mënyrë eksplicite me nenin 348, paragrafi 1, fjalia e parë LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008 fillon të kalojë për secilën palë nga *data kur kopja e saj është pranuar nga ai/ajo*. Për të prodhuar këto pasoja ligjore, njoftimi i saj duhet të përputhet me të gjitha rregullat e njoftimit relevant të Kapitullit XI të LPK-së 1977.

24. Neni 142, paragrafi 1, fjalia e parë LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008 përcakton se aktgjykimi duhet ti dorëzohet *palës personalisht*, përfaqësuesit të tij/saj apo *përfaqësuesit të autorizuar personalisht*. Në lidhje me rëndësinë e procedurave, dërgimi personalisht është i detyrueshëm dhe është i kufizuar në njërin nga këto tri alternativa, të cilat tani janë të riprodhuara në nenin 110, paragrafi 1 LPK 2008. Asnjëra nga ato nuk është realizuar në këtë lëndë për të paditurit.

25. Adresat e këtyre palëve ndërgjyqëse nuk janë identifikuar në C.nr.610/2002 të GJK të Gjilanit – paditësi nuk ka qenë i obliguar nga gjykata të kompletojë padinë me atë bazuar në nenin 281 në lidhje me nenin 109, paragrafët 1 dhe 2 LPK 1977; asnjë ftesë nuk i është dërguar DRAGOLJUB apo JOVAN SIMONOVICIT në mënyrë që të verifikohen zyrtarisht ndryshimet e vendbanimeve të tyre në GJILAN; asnjë informatë lidhur me adresën e tyre të tanishme nuk është marrur *ex officio* nga institucionet administrative kompetente në pajtim me nenin 148 LPK 1977. Në

vazhdim të kësaj, në shkresat e lëndës nuk ka asnjë lajmërim me kopje të aktgjykimit C.nr.610/2002 të GJK të GJILANIT, të datës 12 dhjetor 2002 e dërguar nga kjo gjykatë tek DRAGOLJUB SIMONOVIC apo JOVAN SIMONOVIC në çfarëdo forme, në çfarëdo kohe ,në çfarëdo adrese . Rrjedhimisht , *asnjëri nga dy të paditurit nuk e ka pranuar atë personalisht* siç parashihet qartazi në hipotezën e parë të nenit 142, paragrafi 1, fjalia e parë LPK 1977 dhe neni 110, paragrafi 1 , fjalia e parë LPK 2008. Si rrjedhim periudha 15 ditore sipas nenit 348, paragrafi 1, fjalia e parë LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008 për ankimim të aktgjykimit C.nr.610/2002 të GJK të GJILANIT, të datës 12 dhjetor 2002 për shkak të mos - dërgimit tek DRAGOLJUB apo JOVAN SIMONOVIC personalisht nuk ka filluar për asnjërin dhe nuk ka skaduar për asnjërin prej tyre. Në këtë mënyrë ajo nuk është bërë efektive për këto palë në pajtim me nenin 334, paragrafi 2 LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008 dhe duke qenë të ankimeshme nga ankesat e tyre nuk është bërë e formës së prerë siç parashihet ne nenin 333, paragrafi 1 LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK dhe e definuar me nenin 421 LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008 si parakusht i parë për çfarëdo përsëritje të procedurave civile të përfunduara.

**26.** Hipoteza e *dytë* sipas nenit 142, paragrafi 1, fjalia e parë LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008, që i përgjigjet nenit 110, paragrafi 1, fjalia e parë LPK 2008, *gjithashtu nuk ka ndodhur – aktgjykimi C.nr.610/02 i GJK të GJILANIT, i datës 12 dhjetor 2002 nuk i është dërguar asnjërit nga përfaqësuesit ligjor të paditurve personalisht.* Kjo do të thotë se, kjo kërkesë nuk mund të konsiderohet se është përmbushur me lajmërimin e dorëzuar tek MASAR MORINA, avokat nga GJILANI me 19 dhjetor 2002. Arsyet janë me sa vijon. Në pajtim me nenin 80, paragrafi 2 LPK 1977 *përfaqësuesi ligjor* do të përcaktohet me ligj apo *një akt i institucionit kompetent shtetëror i pranuar në bazë të ligjit.* Në pajtim me këtë dhe i nënshtuar ndaj kushteve të parashtruara në nenin 84, paragrafi 1 LPK 1977, gjykata autorizohet që të emërojë një përfaqësues të përkohshëm për të paditurin me adresë të panjohur dhe pa përfaqësues të autorizuar në pajtim me nenin 84, paragrafi 2, pika 3 LPK 1977. I njëjti do të ketë të gjitha të drejta dhe obligimet në seancat e emërimit të tij të përfaqësuesit ligjor – neni 85, paragrafi 1 LPK. Sidoqoftë , ky status procedural nuk mundet të fitohet *vetëm me një aktvendim të gjykatës sipas nenit 278, paragrafi 1 LPK 1977.* C.nr.610/2002 e GJK të GJILANIT nuk përmban dokumente që verifikojnë ekzistencën e kushteve të parashtruara në nenin 84, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, pika 3 LPK 1977; një akt gjyqësor me përmbajtje përkatëse dhe shpalljen e tij sipas nenit 86 LPK 1977 nuk janë të bashkangjitura në origjinale, e as në kopje në shkresa. Në këto rrethana, përfundimi i vetëm për tu arritur është se *aktvendimi sipas nenit 278, , paragrafi 1 LPK 1977 për emërimin e Avokatit MASAR MORINA si përfaqësues të përkohshëm të paditurve fare nuk është marrur.* Vendimi i tillë gjyqësor në formën e vlefshme me shkrim i përshkruar me nenin 338, paragrafi 1 në lidhje me nenin 347 LPK 1977 dhe duke pasur *përmbajtje të detyrueshme* sipas nenit 338, paragrafët 2 – 5 në lidhje me nenin 347 LPK 1977 mungon në këtë lëndë. Kjo do të thotë mungesë e një akti për emërimin e avokatit MASAR MORINA *si përfaqësues*

*i përkohshëm* i të paditurve sipas nenit 278, paragrafi 1 LPK 1977, si dhe mungesën e veprimit sipas nenit 80, paragrafi 2 LPK 1977 për përcaktimin e tij si *përfaqësues i tyre ligjor*. Moscaktimi i tij si përfaqësues i përkohshëm përjashton në mënyrë automatike statusin e tij si përfaqësues ligjor i këtyre palëve pasi që sipas nenit 85, paragrafi 1 LPK 1977 i dyti është ndihmës për të parin. Si akt i emërimit të gjykatës kompetente sipas nenit 80, paragrafi 2 LPK 1977 është burimi i vetëm i mundshëm i këtij përfaqësimi ligjor procedural, pa një akt të tillë ligjor të detyrueshëm, autorizimi që rezulton nga ajo nuk ishte bërë fare në C.nr.610/2002 nga GJK e GJILANIT. Për këtë arsye rasti i pjesëmarrjes së avokatit MASAR MORINA ishte vetëm *faktik* pasi që *ligjërish* ai nuk ka qenë i autorizuar sipas nenit 80, paragrafi 2, neni 278, paragrafi 1 dhe neni 85, paragrafi 1 LPK 1977 për të përfaqësuar ndonjërin nga të paditurit. Kjo është arsyeja pse ai nuk ka mundur të ndërmer në emër të tyre ndonjë veprim procedural në lëndë, siç parashihet me nenin 81, paragrafi 1 LPK 1977. Prandaj njoftimi me aktgjykimin C.nr.610/2002, i datës 12 dhjetor 2002 ka qenë vetëm *de facto* i pranuar nga Avokati MASAR MORINA me 19 dhjetor 2002 pa qenë *de jure* dërgimi i tij tek *përfaqësuesi ligjor* i të paditurve në hipotezën e dytë të nenit 142, paragrafi 1, fjalia e parë LPK 1977, që korrespondon tani me nenin 110, paragrafi 1, fjalia e parë LPK 2008. Pasi që njoftimi ishte pranuar nga ky avokat pa të drejtë procedurale sipas nenit 85, paragrafi 1 LPK 1977 për DRAGOLJUB dhe/apo JOVAN SIMONOVIC në shkelje të nenit 138, paragrafi 1 LPK 1977, ai është *i pavlefshëm dhe jo i detyrueshëm për këto palë ndërgjyqëse*. Kjo do të thotë se, *ky dërgim i aktgjykimit për shkak të mungesave nuk mundet të iniciohet në mënyrë të rregullt për ata për periudhën prej 15 ditëve për ankimim*. Pasi që kapaciteti i kërkuar në mënyrë të rregullt i përfaqësuesit të përkohshëm (ligjor) është kusht për vlefshmërinë për të gjitha veprimet procedurale të ndërmarra në emër të palëve (Neni 81, paragrafi 1 dhe neni 85, paragrafi 1 LPK 1977), mungesa e këtij statusi për Avokatin MASAR MORINA në këtë lëndë e bën të *pavlefshëm gjithashtu edhe heqjen e ankesës sipas nenit 349, paragrafi 1 LPK 1977 kundër aktgjykimit C.nr.610/2002 të GJK të GJILANIT të datës 12 dhjetor 2002, e shënuar nga ai në faturën e 19 dhjetorit 2002*. I kryer pa fuqinë e përfaqësimit ai nuk ka efekt ligjor ne procedura- nuk e ka penguar të drejtën e ankesës së të paditurve dhe nuk e ka bërë aktgjykimin e pa-ankimueshëm nga ata. Duke u bazuar në këto arsye, pjesëmarrja e Avokatit MASAR MORINA në lëndën C.nr.610/02 duhet të cilësohet vetëm si *faktike* – pa aktvendim për emërimin e tij nga gjykata si përfaqësues ligjor/i përkohshëm i të paditurve sipas nenit 80, paragrafi 2 dhe neni 278, paragrafi 1 LPK 1977, ai kurrë nuk e ka fituar këtë status, prandaj të gjitha veprimet e tija procedurale ishin të paligjshme dhe të konsideruara si të anuluar në pajtim me nenin 83, paragrafi 4 LPK 1977. Dërgimi i aktgjykimit C.nr.610/2002 i GJK të GJILANIT i datës 12 dhjetor 2002 tek Avokati MASAR MORINA me 19 dhjetor 2002 *nuk është për përfaqësuesin ligjor të paditurve në hipotezën e dytë të nenit 142, paragrafi 1, fjalia e parë LPK 1977*. Për këtë arsye periudha kohore e përshkruar me nenin 348, paragrafi 1, fjalia e parë LPK 1977 nuk ka filluar të ec nga ajo datë për të paditurit. Rrjedhimisht, aktgjykimi mbeti i

pakundërshtueshëm , me ankesën e tyre dhe i papërfunduar sipas kritereve të nenit 333, paragrafi 1 LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK.

27. Hipoteza e tretë sipas nenit 142, paragrafi 1, fjalia e parë LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008, që i përgjigjet nenit 110, paragrafi 1, fjalia e parë LPK 2008, *gjithashtu nuk ka ndodhur* – aktgjykimi C.nr.610/2002 i GJK të GJILANIT, i datës 12 dhjetor 2002 *nuk i është dërguar përfaqësuesit të autorizuar të të paditurit personalisht*. Bashkangjitur në shkresat e lëndës është autorizimi i nënshkruar me 20 nëntor 2006 nga DRAGOLJUB SIMONOVIC në emër të ZEJNEPE YMERIT nga projekti i të Drejtës Civile në GJILAN - CRP/K GJILAN për të kërkuar në emër të tij tri aktgjykime , duke përfshirë edhe atë të C.nr.610/2002 e GJK të GJILANIT, të datës 12 dhjetor 2002, në gjuhën serbe dhe shqipe. Siç është e shprehur qartazi në përmbajtjen e saj, duke e nënshkruar këtë autorizim, në pajtim me nenin 90, paragrafi 1 dhe neni 94 LPK 1977, ky i paditur autorizoi ZEJNEPE YMERIN *si person fizik*. Sidoqoftë, pasi që ky autorizim ishte paraqitur në lëndë, gjykata dërgoi njoftimin me aktgjykimin e 12 dhjetorit 2002 tek *CRP/K GJILAN në vend të përfaqësueses ZEJNEPE YMERI si marrës*. Dëftesa ishte kthyer në lëndë *me nënshkrim të palexueshëm të pranuesit dhe datën e pranimit me shkrimin e tij/saj-29.01.2007 pa asnjë shënim për emrin dhe pozitën e këtij personi*. Sa kohë që ky lajmërim nuk ishte drejtuar në mënyrë formale nga gjykata për ZEJNEPE YMERIN, dhe ky emër nuk ishte shënuar në dëftesën e 29 janarit 2007, asnjë nga kërkesat e përgjithshme për dërgim tek përfaqësuesi i autorizuar sipas nenit 38, paragrafi 1 dhe nenin 141, paragrafi 1 LPK 1977 nuk është përmbushur. Për më shumë, e pa-përmbushur ishte rregulli specifik sipas nenit 142, paragrafi 1, fjalia e parë LPK 1977 *për dorëzimin e aktgjykimit te ky përfaqësues i autorizuar personalisht*. Për shkak të të gjitha këtyre parregullsive,njoftimi i datës 29 janar 2007 nuk e ka iniciuar periudhën për ankesë të aktgjykimit C.nr.610/2002 e GJK të GJILANIT, të datës 12 dhjetor 2002 apo DRAGOLJUB SIMONOVICIT. Për më shumë, ai nuk ka absolutisht *asnjë efekt ligjor në lidhje me JOVAN SIMONOVICIN pasi që autorizimi i ZEJNEPE YMERIT nga CRP/K GJILAN nuk ishte nënshkruar nga ai*. Ky i paditur kurrë nuk ka dhënë autorizim në këtë lëndë sipas nenit 94, paragrafi dhe neni 97, paragrafi 1 LPK 1977 për të përcaktuar këtë apo ndonjë person tjetër si përfaqësues të tij të autorizuar në pajtim me nenin 89, paragrafi 1 dhe neni 90, paragrafi 1 LPK për veprime procedurale specifike apo tërë procedurat në pajtim me nenin 94, paragrafi 1 LPK 1977. Kjo përjashton *faktikisht dhe ligjërisht mundësinë e çfarëdo dërgimi të aktgjykimit të lëndës C.nr.610/2002, të datës 12 dhjetor 2002 tek një përfaqësues i autorizuar i të paditurit JOVAN SIMONOVIC dhe e hipoteza e tretë e bën të paaplikueshëm sipas nenit 142, paragrafi 1, fjalia e parë LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008*.

28. Përfundimi i aktgjykimit C.nr.610/2002 i GJK të GJILANIT, i datës 12 dhjetor 2002 nuk mund të arsyetohet me përmbajtjen e kërkesës për rihapje në pjesën me parashtrime se me 1 shkurt 2008, gjersa ka kërkuar nga Drejtorati për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi GJILAN Listën Poseduese për pasurinë e paluajtshme kontestuese DRAGOLJUB SIMONOVIC vërejtji se ajo ishte regjistruar në emrin e

paditësit dhe u njoftua për këtë aktgjykim. *Në rend të parë*, periudha 15-ditore për ankimim në pajtim me nenin 348, paragrafi 1, fjalia e parë LPK 1977 mundet të fillojë vetëm pasi një *kopje e aktgjykimit i është dërguar në mënyrë të rregullt nga gjykata për palën*. Kjo kërkesë është e domosdoshme *për rregullin* duke qenë se vetëm pas pranimit të tekstit të plotë të aktit juridik në kopje zyrtare pala do të mundësohet që të ankimojë atë me efekt. Për këtë arsye, është e papranueshme se periudha 15 ditore sipas nenit 348, paragrafi 1, fjalia e parë LPK 1977 duke qenë e pengueshme për këtë të drejtë procedurale të palëve ndërgjyqëse inicohet nga veprimi faktik dhe /apo ligjor, ndryshe nga ai i kërkuar me këtë dispozitë – dorëzim i rregullt në mënyrë procedurale i kopjes së aktgjykimit nga gjykata tek pala. Për këtë arsye, data 1 shkurt 2008 kur DRAGOLJUB SIMONOVIC kuptoi në Drejtoratin për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë- -GJILAN për aktgjykimin në C.nr.610/2002 të GJK të GJILANIT, nuk ka mundur të definojë momentin fillestar për periudhën 15 ditore për ankimin siç kërkohet në nenin 348, paragrafi 1, fjalia e parë LPK 1977 si një alternative e dërgimit të tij në kopje të plotë nga gjykata. *Në anën tjetër*, kërkesa për rihapje ishte dorëzuar për DRAGOLJUB apo JOVAN SIMONOVIC nga VLASTIMIR PETROVIC dhe ELMI QERIMI, Avokatë nga GJILANI, bazuar në autorizimin e dhënë me 6 shkurt 2008 *vetëm nga i padituri i parë dhe jo nga i dyti*. Kjo është arsyeja pse thënie në këtë kërkesë për rihapje se me 1 shkurt 2008 DRAGOLJUB SIMONOVIC u njoftua për aktgjykimin C.nr.610/2002 e GJK të GJILANIT, nuk kanë të bëjnë në asnjë mënyrë me JOVAN SIMONOVICIN, në veçanti si pranim sipas nenit 221, paragrafi 1 LPK 1977. Pasi që JOVAN SIMONOVICIN nuk e ka nënshkruar autorizimin e datës 6 shkurt 2008, avokatët e përmendur nuk kanë qenë të autorizuar që të përfaqësojnë atë në këtë lëndë sipas 94, paragrafi 1 LPK 1977. Prandaj, në pajtim me nenin 92 LPK 1977 ata nuk kanë qenë të autorizuar të ndërmarrin ndonjë veprim procedural në emër të tij, që do të thotë të pranojë ndonjë fakt lidhur me afatet ligjore për ankimim kundër aktgjykimit C.nr.610/2002 të GJK të GJILANIT, të datës 12 dhjetor 2002 dhe/apo të pranojë formën e prerë të tij sipas nenit 333, paragrafi 1 LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK.

**29.** Hyrja në fuqi e çfarëdo vendimi të gjykatës mundet të ndodh pas skadimit të periudhës së ankimimit për të *gjitha palët ndërgjyqëse*. Prandaj, fakti që shpallja e aktgjykimit C. nr.610/2002 e GJK të GJILANIT, të datës 12 dhjetor 2002 për të paditurin JOVAN SIMONOVIC as nuk ka qenë i vërtetuar nga gjykata siç kërkohet me ligj e as nuk ka qenë i pranuar jozyrtarisht nga ai dhe apo përfaqësuesi i tij (ligjor apo i autorizuar), është e mjaftueshme të përjashtojë skadimin e periudhës 15-ditore për ankimim sipas nenit 348, paragrafi 1, fjalia e parë LPK 1977 *për këtë palë ndërgjyqëse dhe kështu që hyrja në fuqi e aktvendimit të njëjtë në tërësi, gjithashtu në lidhje edhe me palët e tjera*.

**30.** Në kundërshtim me nenin 103, paragrafi 2 LPK, aktgjykimi C.nr.610/02 i GJK të GJILANIT i datës 12 dhjetor 2002 kurrë nuk i është dërguar ndonjërit nga të paditurit në gjuhën serbe. Kjo shkelje e rregullës gjuhësore në procedurat civile të parashtruar me nenin 6 të LPK 1977 është një bazë shtesë të përjashtojë rregullsinë e

dorëzimit dhe pasojat e saj ligjore të parashtruara në nenin 348, paragrafi 1, fjalia e parë LPK 1977.

**31.** Në parim përsëritja sipas Kapitullit XXVI, artikulli 5 i LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008 siç arsyetohet më lart është në mënyrë ekskluzive i lejueshëm *për procedura të përfunduara me akte gjyqësore që kanë hyrë në fuqi*. Kjo kërkesë e pranueshmërisë absolute e nenit 421 LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008 nuk është përmbushur pasi që aktgjykimi C. nr.610/2002 i GJK të GJILANIT, të datës 12 dhjetor 2002 *nuk e ka marrur formën e prerë* sipas kriterit të nenit 333, paragrafi 1 LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008. Pa qenë *aktgjykim i formës së prerë*, nuk mund të jetë subjekt i mjetit të jashtëzakonshëm juridik siç udhëzohet nga Kapitulli XXVI, neni 5 i LPK 1977. Kjo e fundit është e paaplikueshme gjersa mjeti i zakonshëm juridik nëpërmjet ankesës në gjykatën e shkallës së dytë nuk është përdorur për të paditurit. Për të përmbledhur, kërkesa për rihapje është e *pa pranueshme* duke qenë e paraqitur kundër aktgjykimit C.nr.610/02 e GJK të GJILANIT, të datës 12 dhjetor 2002, *i cili si vendim gjyqësor i shkallës së parë i formës jo të prerë është i pa pranueshëm për përsëritjen e propozuar sipas nenit 421 – 428 LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008*.

**32.** Në lidhje me JOVAN SIMONOVIC, siç përmendet në nenin 28 më lart, kërkesa për rihapje është dorëzuar nga VLASTIMIR PETROVIC dhe ELMI QERIMI, avokatë nga GJILANI, *pa asnjë autorizim me shkrim për përfaqësimin e tij*. E pakonfirmuar pastaj nga ky i paditur, mbetet i paligjshëm për të. Si i tillë duhet të anulohet në pajtim me nenin 98, paragrafi 1 LPK 1977 në lidhje me 533, paragrafi 1 LPK 2008 dhe në këtë bazë ligjore plotësuese duhet të cilësohet si e palejueshme sipas nenit 425, paragrafi 1 LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008.

**33.** Nëse në mënyrë hipotetike, aktgjykimi C.nr.610/2002 i GJK të GJILANIT, i datës 12 dhjetor 2002 konsiderohet si i formës së prerë atëherë kërkesa për rihapje do të jetë e *vonuar*. Si bazë ligjore qartazi e kërkuar në përmbajtjen e saj sipas nenit 424, paragrafi 2 LPK 1977 është ajo sipas *nenit 421, pika 2 LPK 1977*, afati për dorëzimin e saj është i definuar me: 1) neni 423, paragrafi 1, pika 2 LPK 1977 - 30 ditë nga data kur vendimi i është dorëzuar palës ; *dhe* 2) neni 423, paragrafi 2 LPK 1977 duke përcaktuar se nëse periudha kohore sipas nenit 423, paragrafi 1 LPK 1977 ka filluar të ecë para se vendimi të bëhet i formës së prerë, momenti i saj fillestar do të jetë data e përfundimit nëse nuk është paraqitur asnjë ankesë kundër tij. I llogaritur nga 19 dhjetori 2002 (kur dorëzimi i kopjeve të aktgjykimit C.nr.610/2002, të datës 12 dhjetor 2002 *de facto* ka ndodhur me heqjen dorë nga ankimimi) periudha 30 ditore sipas nenit 423, paragrafi 2 në lidhje me paragrafin 1, pika 2 LPK 1977 do të kishte kaluar me 18 janar 2003. Kërkesa për rihapje ishte paraqitur me 7 shkurt 2008, pas këtij afati. Prandaj me përfundimin e supozuar teorikisht të aktgjykimit C.nr.610/2002 e GJK të GJILANIT, të datës 12 dhjetor 2002, e drejta procedurale e të paditurve për përsëritje do të *pengohej* me skadimin e periudhës kohore prej 30 ditëve sipas nenit 423, paragrafi 2 LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008.

#### IV. Konkluzion

34. Pas këtij vlerësimi të pranueshmërisë, kërkesa për rihapje e përfunduar me aktgjykimin C.nr.610/2002 e GJK të GJILANIT, të datës 12 dhjetor 2002 do të *hudhet poshtë* me nenin 425, paragrafi 1 LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008 bazuar në *bazat e pranueshmërisë* të përcaktuar më lart, pa seancë dëgjimore. Në këtë hipotezë kopja e saj nuk duhet ti dërgohet palës kundërshtare për përgjigje sipas kërkesës eksplicite të nenit 425, paragrafi 2 LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008. Asnjë veprim procedural i mëtutjeshëm sipas neneve 426 – 427 LPP 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008 nuk duhet të ndërmerren në këtë mjet juridik të jashtëzakonshëm pasi që me hedhjen e tërësishme poshtë sipas nenit 425, paragrafi 1 LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008 ajo ka përfunduar.

35. Në mënyrë që të largohen të gjitha të metat në dërgimin e aktgjykimit C.nr.610/2002 të GJK të GJILANIT, të datës 12 dhjetor 2002, të identifikuar më lart, dorëzimi i ri tek të paditurit do të urdhërohet. Ai duhet të jetë në kopje zyrtare të vërtetuara me përkthim në gjuhën serbe në pajtim me nenin 348, paragrafi 1, fjalia e parë dhe neni 142 LPK 1977 në lidhje me nenin 533, paragrafi 1 LPK 2008, që tani korrespondon me nenin 176, paragrafi 1, fjalia e parë dhe neni 110, paragrafi 1, fjalia e parë LPK 2008, kështu që të paditurve iu jepet e drejta për të ankimuar këtë aktgjykim të shkallës së parë para gjykatës kompetente të shkallës së sytë në një procedure të rregullt të mjetit juridik.

Duke marrë parasysh arsyetimin e sipërpërmendur është vendosur si në diapozitiv.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky aktvendim mund të ankimohet me një ankesë në Gjykatën e Qarkut të Gjilanit brenda periudhës prej 15-ditëve nga data e pranimit nga palët.

**GJYKATA KOMUNALE E GJILANIT**  
**C. nr.610/2002 me 12.05.2011**

**KRYETARE E TRUPIT GJYKUES**

**ROSITZA BUZOVA**

**Përkthyer nga anglishtja në shqip nga:**  
**Mejreme Ymeri, perkthyesë në EULEX**



*Përgatitur në Gj. Angleze si gjuhë zyrtare, në përputhje me Nenin 17 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e lëndëve dhe Kaktimin e lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.*

## NJOFTIM MBI KËSHILLIM DHE VOTIM

**GJYKATA KOMUNALE E GJILANIT**, në kolegjin gjyqësor të përbërë nga Gjyqtarja e EULEX-it ROSITZA BUZOVA, si kryetare e kolegjit, gjyqtari vendor BERAT SPAHIU dhe gjyqtari vendor HALIL ZAHIRI, si anëtarë të kolegjit, **me 12 maj 2011 diskutuan dhe votuan unanimitisht si në dispozitivin e këtij aktvendimi.**

Ky njoftim i bashkëngjitet Aktvendimit të GJYKATËS KOMUNALE të GJILANIT C. nr.610/2002, të datës 12 maj 2011.

### **GJYKATA KOMUNALE E GJILANIT C. nr.610/2002, me 12.05.2011**

**ROSITZA BUZOVA,  
KRYETARJA E KOLEGJIT GJYQËSOR**

**BERAT SPAHIU  
ANËTAR I KOLEGJIT**

**HALIL ZAHIRI  
ANËTAR I KOLEGJIT**

**ANDRES MORENO  
ZYRTAR LIGJOR I EULEX-IT**

**MEJREME YMERI  
PËRKTHYESE (ANGLISHT/SHQIP)**

**Përkthyer nga anglishtja në shqip nga:  
Mejreme Ymeri, perkthyesë në EULEX**



*Përgatitur në Gj. Angleze si gjuhë zyrtare, në përputhje me Nenin 17 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e lëndëve dhe Caktimin e lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë dhe e nënshkruar nga gjyqtarët vendor pas përkthimit të bërë nga përkthyesja e cekur më lart.*